



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3458 Prot.

Tiranë, më 10/11/2023

**Lënda:** Kërkesë për marrjen e masës disiplinore

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA

**KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**Baza Ligjore:** *Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.*

*Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.*

*E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,*

Situata e përsëritur në çdo fillim seance plenare nga deputetë të opozitës duke penguar zhvillimin e rregullt të saj është e pa tolerueshme. Kaosi i krijuar nga deputetë të caktuar të opozitës në seancën plenare të datës 09.11.2023, duke larguar nga vendet karriget dhe vendosur ato si barrikadë përpara foltores duke e bllokuar atë është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë.







Situata në sallën plenare u përkeqësua akoma më shumë kur deputeti Saimir Korreshi u pa të merre disa tymuese nga çantat e dy zonjave deputete Elda Hoti dhe Lindita Metaliaj, duke i

ndezur ato dhe duke e bërë të pamundur dhe të vështirë zhvillimin normal të rendit të ditës dhe diskutimet e deputetëve të regjistruar.

Nisur nga këto situata të krijuara në mbështetje të nenit 63, pika 1 gërma d), dhe nenit 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe ë), nenin 8, pika 2 gërma b) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Saimir Korreshi, Elda Hoti dhe Lindita Metaliaj sipas nenit 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT:

1. Blencia Gjykoeti 
2. Ilirien Bandenji 
3. Muela Pitushi 
4. Gjyresa Kernoj 
5. Enxhemve Zeke 
6. Edono Bilali 
7. Klotra Sjekuri 